




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

*Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency*



RAPORTI VJETOR



Punës së Këshillit Shtetëror
të Cilësisë dhe i Agjencisë së
Kosovës për Akreditim për Vitin 2020

PRISHTINË, 2021

RAPORTI VJETOR

Punës së Këshillit Shtetëror
të Cilësisë dhe i Agjencisë së
Kosovës për Akreditim për Vitin 2020



Mbështetur nga:

Qaint

Dizajn:

Envinion

Ky raport është mbështetur nga projekti Cilësia, Llogaridhënia, Integriteti dhe Transparenca në Arsimin e Lartë (ang.QAINT).

Projekti QAINT financohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ang. ADA), me kontribut të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe zbatohet nga konsorciumi KEC, ORCA dhe ZSI.

PËRMBAJTJA

1. SHKURTESAT	7
2. AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM (AKA)	8
3. KËSHILLI SHTETËROR I CILËSISË (KSHC)	11
4. MBLEDHJET E KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË DHE VENDIMET NË VITIN 2020 ...	13
5. PROCESI I VLERËSIMIT DHE AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË NË VITIN 2020	14
5.1. AKREDITIMI INSTITUCIONAL I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË NË VITIN 2020.....	17
5.1.1. AKREDITIMI INSTITUCIONAL I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË PUBLIK NË VITIN 2020.....	18
5.1.2. AKREDITIMI INSTITUCIONAL I INSTITUCIONEVE NË ARSIMIT TË LARTË PRIVAT NË VITIN 2020.....	19
5.2. AKREDITIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË VITIN 2020	20
5.2.1. AKREDITIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PUBLIK	21
5.2.2. AKREDITIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PRIVAT.....	23
6. MONITORIMI.....	24
7. APROVIMI I STANDARDEVE TË REJA TË PHD 2020.....	25
8. KOMISIONI I ANKESAVE.....	27
9. SIGURIMI I BRENDSHËM I CILËSISË SË PUNËS SË AKA	28
10. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR, PARTNERITETI DHE PROJEKTET	29
11. MENAXHIMI I TË DHËNAVE.....	32
12. MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN	33
13. REKOMANDIMET E ENQA-SË DHE VEPRIMET E DOMOSDOSHME PËR PËRMBUSHJEN E TYRE	34

1. SHKURTESAT

ADA	Agjencia Austriake për Zhvillim
AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
CEENQA	Rrjeti i Evropës Qendrore dhe Lindore për Sigurimin e Cilësisë
ENQA	Rrjeti Evropian për Sigurimin e Cilësisë
EQAR	Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë
ESG	Standardet dhe Udhëzuesit Evropian për Sigurimin e Cilësisë
HERAS	Higher Education, Research and Applied Science Plus
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
IAL publik	Institucionet e Arsimit të Lartë të financuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës
IAL privat	Institucionet e Arsimit të Lartë të vet-financuara
INQAAHE	Rrjeti Ndërkombëtar i Agjencive për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë
KA	Komisioni i Ankesave i cili shqyrton ankesat e pranuar nga IAL për vendimet e KSHC-së
KKK	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
KSHC	Këshilli Shtetëror i Cilësisë
Ligji për AL	Ligji për Arsimin e Lartë
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës , Teknologjisë dhe Inovacionit
QAINT	Projekti Cilësi, Llogaridhënie, Integritet dhe Transparencë në Arsimin e Lartë
RVV	Raporti i Vetëvlerësimit
SC	Sigurimi i Cilësisë
UA	Udhëzim Administrativ
WUS Kosova	World University Service Kosovë

2. AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM (AKA)

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) është agjenci publike, e pavarur, e cila bën akreditimin dhe ri akreditimin e institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë në Kosovë dhe programeve të tyre të studimit. Ajo u themelua nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në vitin 2008, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë Nr. 2003/14.¹

Përmes procesit të akreditimit, AKA mbështet zhvillimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe në këtë mënyrë siguron shoqërinë se ofertat për arsim të lartë në Kosovë përkojnë me standardet e krahasueshme ndërkombëtare.

Baza ligjore për aktivitetin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) janë Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë (Nr. 04/L-037, datë 31.08.2011) dhe Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 15/2018)² i cili gjatë vitit 2019 pësoi tri herë ndryshime nga MASHT (UA 02/2019³; UA 08/2019⁴, gjegjësisht UA 13/2019)⁵

Konform nenit 7. të LAL (Nr. 04/L-037), AKA realizon përgjegjësitë e saj, që janë: Këshillimin me Ministrinë lidhur me kërkesat e institucioneve për licencimin e kurseve apo programeve të tyre; inspektimin e bartësve të arsimit të lartë dhe këshillimin me Ministrinë lidhur me dhënien, ndryshimin ose anulimin e licencave; kryerjen e kontrolleve periodike mbi cilësinë e

1 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/2-ligji-per-arsimin-e-larte.pdf>

2 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/10/ilovepdf-merged.pdf>

3 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/07/4dd5f6a7-x.pdf>

4 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/05/ua-masht-08-2019-per-ndryshim-dhe-plotesim-te-ua-nr-15-18.pdf>

5 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/07/4dd5f6a7-x.pdf>

bartësve të licencuar të arsimit të lartë dhe marrjen e vendimit për akreditimin apo ri akreditimin e tyre, kryerjen e vlerësimeve periodike të cilësisë së programeve të ofruara nga bartësit e akredituar të arsimit të lartë.

AKA bën akreditimin në këto nivele:

- Akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë
- Akreditimi i programeve të studimit
- Akreditimi i institucioneve dhe programeve të studimit
- Akreditimi i degëve dhe programeve të studimit të cilat ofrohen në ato degë
- Njohjen/validimin e akreditimit ndërkombëtar

Që nga themelimi i saj, AKA në përputhje me Standardet dhe Udhëzuesit Evropian për Sigurimin e Cilësisë (ESG)⁶ ka zhvilluar të gjitha standardet dhe procedurat për akreditim dhe i ka publikuar ato përmes ueb faqes së saj zyrtare.⁷

Kërkesa për akreditim mund të bëhet nga:

- Vet institucioni i arsimit të lartë për tu vlerësuar në nivel institucional apo të programeve të studimit
- Ministria e arsimit, shkencës, teknologjisë dhe inovacionit (MASHTI)
- Këshilli Shtetëror i Cilësisë i AKA, në raste të veçanta

6. https://www.enqa.eu/wp-content/uploads/2015/11/ESG_2015.pdf

7. <https://akreditimi.rks-gov.net/guidelines/>

Me qëllim të zhvillimit të një procesi transparent të akreditimit, AKA ka përgatitur të gjitha dokumentet e nevojshme mbi procedurat e akreditimit të cilat mund të shfrytëzohen nga IAL-ët, sikurse janë: Standardet e AKA-së, Udhëzuesit e AKA-së për Hartimin e Raportit të Vet-vlerësimit (RVV) për vlerësimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit, përkatësisht Manualin e Akreditimit⁸. Këto dokumente kanë shërbyer jo vetëm si udhëzues për institucionet e arsimit të lartë për qëllim të procesit të akreditimit por edhe si udhëzues për sigurimin dhe menaxhimin e brendshëm të cilësisë.

AKA përbëhet nga struktura administrative e saj, e cila udhëhiqet nga Drejtori, dhe nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) i cili është organ qeverisës dhe vendim-marrës i AKA. Struktura administrative e AKA momentalisht ka të punësuar drejtorin dhe 8 zyrtarë.

Ndërhyrjet e shpeshta të politikës në emërimin dhe shkarkimin e Drejtorit të AKA, bënë që ajo të funksionojë me U.D drejtor gjer në mars të vitit 2020. Këto ndërrime të shpeshta, padyshim, kanë ndikuar edhe në efikasitetin e punës së AKA-ës, posaçërisht në kohën kur ajo u përjashtua nga Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë- EQAR në vitin 2018,⁹ dhe humbi statusin e anëtarit të plotë në Rrjetin Evropian të Sigurimit të Cilësisë-ENQA¹⁰, pas një rivlerësimi në vitin 2019.

Pas një procesi profesional dhe transparent të rekrutimit, të mbikëqyrrur dhe mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë të Bashkuar në Kosovë, më 6 Mars të vitit 2020, z. Naim Gashi u miratua si Drejtor i AKA-së me shumicë të votave në Qeveri të Kosovës.¹¹ Kështu, për herë të parë që nga viti 2014, AKA ka pozitën e rregullt të drejtorit, i cili pritet që të sjellë qëndrueshmëri në menaxhimin e AKA dhe ngritjen e efikasitetit të punës së saj.

Drejtori i AKA është anëtar i KSHC-së pa të drejtë vote.

8 8. <https://akreditimi.rks-gov.net/accreditation/standards/>

9 EQAR https://www.eqar.eu/assets/uploads/2018/04/T_180313_KAA_PublicStatement.pdf

10 ENQA <https://www.enqa.eu/review-database/external-review-report-of-kaa-2/>

11 <https://kallxo.com/arsim/dy-vite-pas-shpalljes-se-konkursit-emerohet-drejtori-i-agjencise-se-akreditimit/>

3. KËSHILLI SHTETËROR I CILËSISË (KSHC)

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) është organ qeverisës i Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe është përgjegjës për marrjen e vendimeve për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit. Veprimtaria e KSHC-së bazohet në Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037.¹²

Përzgjedhja e anëtarëve të KShC-së përcaktohet sipas dispozitave të Ligjit të Arsimit të Lartë, përkatësisht nenit 7, paragrafi 4 i cili përcakton se *“AKA duhet të qeveriset nga një bord i përbërë nga jo më pak se pesë dhe jo më shumë se nëntë persona, të emëruar nga Ministria për një mandat të caktuar, i cili duhet të përbëhet nga radhët e personave të të dy gjinive, që janë aktivë në punën akademike të arsimit të lartë dhe /ose në profesione brenda dhe jashtë Kosovës dhe i cili duhet të ketë të paktën tre persona (‘ekspertë ndërkombëtarë’), që nuk janë të punësuar nga asnjë bartës i arsimit të lartë në Kosovë. Ky bord do të quhet Këshilli Shtetëror i Cilësisë i AKA-së. Anëtarët e tij ratifikohen nga Kuvendi. Vendimet apo rekomandimet lidhur me akreditimet, Këshilli i merr me shumicën e votave të anëtarëve të vet. Këshilli i raporton çdo vit Ministrisë dhe Kuvendit lidhur me aktivitetet e veta të akreditimit dhe me përshtatshmërinë e infrastrukturës mbështetëse që ka në dispozicion”*.

Përpos Ligjit të Arsimit të Lartë, MASHT ka hartuar një Udhëzim të veçantë Administrativ për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të KSHC-së (Nr. 05/2018, dt.15.03.2018).¹³ Lista e përzgjedhur e të nominu-

¹² <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/2-ligji-per-arsimin-e-larte.pdf>

¹³ <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/05/ua-nrmash-06-2018-per-kriteret-dhe-procd-e-emerimit-te-ane-tareve-te-kshcaka-x.pdf>

arve ratifikohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ky UA mundëson përzgjedhjen e anëtarëve të KSHC-së mbi bazën e kritereve dhe procedurave profesionale dhe transparente, të cilat janë aplikuar për herë të parë në Kosovë që nga themelimi i Agjencisë së Akreditimit. Puna e KSHC-së bazohet në Rregulloren mbi Punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (Nr. 621/18D, dt.12.06.2018)¹⁴, i cili është dokument i publikuar në ueb faqen e AKA-së. Sipas kësaj rregulloreje, KSHC cakton agjendat vjetore për procesin e akreditimit të IAL-ve, aprovon standardet, procedurat dhe kriteret e akreditimit, aprovon Ekipet e ekspertëve të jashtëm, të propozuara nga drejtori i AKA, merr vendimet për akreditim si dhe aprovon Statutin dhe të gjitha Rregulloret e AKA.

Gjatë vitit 2020 KSHC ka funksionuar me 8 anëtarë me përbërjen e saj, pesë anëtarë vendor dhe tre ndërkombëtarë, të emëruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në vitin 2018, ekspertë të fushave të ndryshme.

Një anëtar vendor i KSHC-së kishte dhënë dorëheqje në vitin 2019 dhe ky ishte zëvendësuar me një anëtar tjetër të propozuar nga ministri i MASHT, pa u ratifikuar në Kuvendin e Kosovës, siç parasheh Ligji për arsimin e lartë.

Përbërja e KSHC-së në vitin 2020:

- Prof. Dr. Gazmend Luboteni, kryetar
- Prof. Asoc. Dr. Vjollca Krasniqi, nënkryetare
- Prof. Asoc. Dr. Arta Basha - Jakupi
- Dr. Sc. Spec. Rozafa Koliqi-Lila
- Prof. Dr. Magdalena Ziolo
- Prof. Dr. Herbert K. Amato
- Prof. Msc. Jeffery Butel
- Prof. Ass. Dr. Dukagjin Zeka
- Prof.ass. Binak Beqaj-i emëruar nga ministri i MASHT-it

¹⁴ <https://drive.google.com/file/d/0B7etG3bh-SBVVkt4T2J5bmZuOTdYVFN4bFZmMnFwax3Z0tR/view?resourcekey=0-QuhrtZa6eTC2uklLt0rUjw>

4. Mbledhjet e Këshillit Shtetëror të Cilësisë dhe vendimet në vitin 2020

Gjatë vitit 2020, KSHC ka mbajtur gjashtë mbledhje, prej tyre pesë ishin të rregullta kurse një ishte e jashtëzakonshme.

1. 16-17.01. 2020, mbledhja e 79-të e KSHC-ës
2. 1.04.2020, mbledhja e 80-të e KSHC-ës (mbledhje e jashtëzakonshme), vazhdim e mbledhjes së janarit (e mbajtur online për shkak të rrethanave të pandemisë Covid-19)
3. 17.04.2020, mbledhja e 81-të e KSHC-së (online)
4. 25.06.2020, mbledhja e 82-të e KSHC-së (online)
5. 2-3.09.2020, mbledhja e 83-të e KSHC-së (online)
6. 10-11. 12.2020, mbledhja e 84-të e KSHC-së (online)

5. PROCESI I VLERËSIMIT DHE AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË NË VITIN 2020

Vlerësimi institucional dhe i programeve të studimit është një aktivitet periodik i AKA-së. Ky proces bazohet në vlerësimin e dokumenteve të dorëzuara nga institucioni aplikues (Raporti i vetëvlerësimit) dhe në bazë të të gjeturave gjatë vizitës në terren me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit. Bazuar në procedurat e publikuara të AKA-së, çdo IAL duhet të dëshmojë se plotëson kriteret e akreditimit me qëllim që të marrë akreditimin.

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për akreditimin e institucioneve të Arsimit të Lartë (Nr. 15/2018), çdo IAL që paraqet kërkesë për akreditimi/riakreditim institucional të një apo më shumë programeve të studimit, së bashku me Aplikacionin/kërkesën duhet të paraqesë edhe listën e stafit akademik, të cilët paraprakisht janë deklaruar në AKA përmes platformës e-akreditimi se janë të angazhuar në atë IAL, në programin përkatës për vitin e caktuar akademik. Aplikacioni, së bashku me listën e stafit i nënshtrohet vlerësimit të përmbushjes së kriterëve formale dhe nëse aprovohet nga KSHC, ai përfshihet në agjendën vjetore të AKA për vlerësim. Në rast të vlerësimit negativ të aplikacionit nga KSHC, ai refuzo-

het dhe nuk i nënshtrohet vlerësimit. IAL, aplikacionet dhe listat e stafit të të cilit janë aprovuar, duhet të sjellë në AKA Raportin e Vet-vlerësimit i cili do të dërgohet Ekipit vlerësues të jashtëm në një afat kohor të caktuar para vizitës, konkretisht para vlerësimit në distancë nëpërmes video konferencës.

Në vitin 2020 AKA realizoi procesin e vlerësimit dhe akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit mbi bazën e standardeve të rishikuara në vitin 2019 dhe Manualit të ri të Akreditimit në të cilën duhet të bazohen IAL gjatë hartimit të RVV. Standardet e reja synojnë avancimin e cilësisë së përgjithshme të IAL-ve në Kosovë dhe fokusohen më shumë në konsolidimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë së tyre.

Për dallim prej viteve tjera, viti 2020 ishte një vit jo i zakonshëm për shkak të pandemisë Covid-19 me të cilën u ballafaqua njerëzimi në mbarë botën. Kjo gjendje ndikoi që edhe AKA të ndryshojë dhe të riorganizojë punën e vet në përputhje me rrethanat dhe rekomandimet e Qeverisë së Kosovës për luftimin dhe parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19. Duke u bazuar në këto rrethana, KSHC në mbledhjen e mbajtur më 19 prill 2020 mori vendim që Agjencia e Kosovës për Akreditim të zhvillojë procesin e akreditimit në distancë. Vendimi përfundimtar për lejimin e akreditimit në distancë është marrë nga ish-ministrja e Arsimit, (Ref: 35/018 Dat-d:07.05.2020).¹⁵ Ky Vendim rregullon procedurat e vlerësimit të jashtëm nga vlerësuesit ndërkombëtarë përmes video konferencës, gjatë periudhës në të cilën janë në fuqi masat e aplikuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës sipas paragrafit 1.2 të vendimit Nr.01/07, të datës 11.03.2020¹⁶, me qëllim të menaxhimit të rrethanave emergjente të krijuara nga pandemia COVID 19, me të cilin, ndër të tjera, është pezulluar përkohësisht transporti ajror dhe tokësor ndërkombëtar duke pamundësuar ardhjen e vlerësuesve ndërkombëtarë për procesin e akreditimit dhe ri-akreditimit në Republikën e Kosovës.

¹⁵ <https://akreditimi.rks-gov.net/about-us/dispozitat/dokumente/>

¹⁶ <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2021/04/Vendimet-e-Mbledhjes-se-7-te-te-Qeverise-se-Republikes-se-Kosoves.pdf>

AKA fillimisht filloi organizimin në distancë të akreditimit institucional të institucioneve të arsimit të lartë, i cili u zhvillua duke shqyrtuar praktikat më të mira të akreditimit në rajon dhe në Evropë gjatë situatës së jashtëzakonshme të pandemisë.

Para se të fillojë procesi, drejtori i Agjencisë dhe zyrtarët e lartë në AKA për vlerësim dhe monitorim, kanë mbajtur trajnime individuale me të gjitha IAL-të që i janë nënshtruar procesit të akreditimit në distancë, ku është shpjeguar në detaje i gjithë procesi. Prosesi i akreditimit në distancë ka qenë i njëjtë me procedurat e mëhershme, me përjashtim të vizitës në institucion, e cila është zhvilluar në distancë. Në pamundësi të pranisë fizike të ekipeve të ekspertëve në institucionin që vlerësohet, verifikimi i hapësirave dhe pajisjeve laboratorike është bërë nëpërmes video incizimeve të përgatitura nga IAL.

Ekipi i AKA-së dhe drejtori kanë qenë prezent fizikisht në të gjitha institucionet ku është zhvilluar procesi i akreditimit dhe janë verifikuar të gjithë personat që kanë marrë pjesë në proces, të gjitha dokumentet e ofruara dhe të gjitha video incizimet.

Me qëllim të informimit sa më të mirë të IAL-ve që kanë qenë në proces të vlerësimit, AKA-ja iu ka dorëzuar një udhëzues me shkrim të gjitha IAL-ve për fillimin e procesit të akreditimit në distancë. Udhëzues i ngjashëm është përdorur edhe për akreditimin e programeve. Gjatë vlerësimit në distancë, me video konferencë, AKA ka shfrytëzuar platformat online. Në rast nevojë për përkthim, në sallën ku janë mbajtur video konferencat ka qenë i pranishëm edhe përkthyesi për përkthimin nga gjuha shqipe në atë angleze dhe anasjelltas.

Pas përfundimit të suksesshëm të vlerësimit në distancë në nivel institucional, në fazën e dytë të procesit, prej muajit korrik 2020 e tutje, AKA vazhdoi me vlerësimin e programeve të studimit në fushat e mjekësisë, ekonomisë dhe jurisprudencës. Këto tri fusha të studimeve janë zgjedhur me vendim të KShC-së, pasi që ato kishin numrin më të madh të studentëve në IAL.

5.1 AKREDITIMI INSTITUCIONAL I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË NË VITIN 2020

Në vitin 2020, AKA realizoi vlerësimin institucional të 14 IAL-ve, prej tyre 5 ishin Universitete publike kurse 9 tjera ishin kolegje private, ndërsa tri kolegjeve të tjera private nuk u janë pranuar aplikacionet për shkak të mospërbushjes së kriterëve të përcaktuara me udhëzimin administrativ.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) më 25.06.2020 mbajti mbledhjen e rregullt, në të cilën u analizuan dhe votuan raportet e ekspertëve ndërkombëtarë mbi vlerësimin e institucioneve të arsimit të lartë. Nga gjithsej 14 institucione të vlerësuara, mbi bazën e rekomandimit të ekspertëve ndërkombëtarë, 6 nga këto institucione u ri-akredituan ndërsa 8 të tjera u refuzuan për ri-akreditim.

Në procesin e vlerësimit institucional të IAL, ishin të angazhuar 9 ekspertë ndërkombëtarë, prej të cilëve 3 ishin studentë ekspertë, ashtu siç kishte rekomanduar ENQA në rekomandimet e saj në Raportin e vlerësimit të AKA në vitin 2019.

5.1.1. AKREDITIMI INSTITUCIONAL I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË PUBLIK NË VITIN 2020










Tabela1. Institucionet publike të Arsimit të lartë që iu nënshtruan akreditimit institucional në vitin 2020 dhe vendimi i KSHC-së për to.

Nr.	Institucioni	Vendimi i KSHC-së
1	Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”	 Akreditohet për 5 vjet
2	Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”	 Akreditohet për 3 vjet
3	Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”	 Akreditohet për 3 vjet
4	Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”	 Akreditohet për 3 vjet
5	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj	 Akreditohet për 3 vjet

Nga 5 universitete publike të vlerësuara, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” u ri akreditua për periudhë maksimale 5 vjet, kurse Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”, Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” të cilat nuk ishin akredituar në vitin 2018 nga AKA, tani u akredituan për periudhë 3 vjeçare. Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj u akreditua për 3 vjet.

5.1.2.AKREDITIMI INSTITUCIONAL I INSTITUCIONEVE NË ARSIMIT TË LARTË PRIVAT NË VITIN 2020

Tabela 2. Institucionet private të arsimit të lartë që iu nënshtruan akreditimit në vitin 2020 dhe vendimet e KSHC-së për to

Nr.	Institucioni	Vendimi i KSHC-së
1	Kolegji Dukagjini	 Nuk akreditohet
2	Kolegji FAMA	 Nuk akreditohet
3	Kolegji Iliria	 Nuk akreditohet
4	Kolegji Tempulli	 Nuk akreditohet
5	Kolegji Pjeter Budi	 Nuk akreditohet
6	Dega e Kolegjit UBT në Ferizaj dhe Prizren	 Akreditoheh për 3 vjet
7	Kolegji Arbëri	 Nuk akreditohet
8	Kolegji Universi	 Nuk akreditohet
9	Kolegji Biznesi	 Nuk akreditohet

Nga 9 kolegjet private që iu nënshtruan akreditimit institucional në vitin 2020, u akredituan vetëm dy degë të Kolegjit UBT, njëra në Ferizaj dhe tjetra në Prizren. Tetë kolegje nuk u akredituan në nivel institucional.

5. 2. AKREDITIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË VITIN 2020

Në vitin 2020 AKA ka pranuar aplikacione për ri akreditimin e gjithsej 258 programeve të studimit në nivelin Bachelor, Master dhe Doktoratë.

Në mbledhjen e KSHC-së të datës 2 dhe 3.09.2020, (mbledhja e 83-të e KSHC-ës e cila u mbajt online), KSHC mori vendim që programeve që janë në ri akreditim t'iu vazhdohet akreditimi për një vit pasi që kanë qenë disa herë të akredituara, kurse programet e reja t'i nënshtrohen vlerësimit.

Po në këtë mbledhje, në bazë të raporteve të vlerësimit nga ekspertët e jashtëm, KSHC mori vendim për akreditim të 29 programeve të studimit: 27 programe kishin rekomandim pozitiv për akreditim, prej tyre 16 në IAL publike dhe 11 në IAL private, kurse 2 programe nuk u akredituan. 3 programe në IAL private ishin akredituar në mbledhjen e KSHC-së në janar 2020.

Sipas vendimeve të mëparshme, pos atyre gjatë vitit 2020, në Republikën e Kosovës kanë qenë të akredituara



362
PROGRAME
AKADEMIKE

→
prej tyre

234 PROGRAME NË
IAL PUBLIKE

128 PROGRAME NË
IAL PRIVATE

5.2.1. AKREDITIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT NË INSTI- TUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PUBLIK

Nga 234 programe akademike që poseduan akreditim
në vitin 2020 në IAL publike,



124

ISHIN TË
NIVELIT
BACHELOR

ku janë
përfshirë
edhe

3 PROGRAME TË
INTEGRUARA

MJEKËSI, STOMATOLOGJI DHE
MJEKËSI VETERINARE



91

TË NIVELIT
MASTER



19

TË NIVELIT TË
DOKTORATËS

KËTYRE IU SHTUAN EDHE 16 PROGRAME TË CILAT U AKREDITUAN
GJATË VITIT 2020,



9

TË NIVELIT
BACHELOR



7

TË NIVELIT
MASTER

Programet e IAL-ve publike që iu nënshtruan vlerësimit dhe u akredituan në vitin 2020:

Institucioni	Programi
Universiteti i Prishtinës	Infermieri BSc
Universiteti i Prishtinës	Fizioterapi-BSc
Universiteti i Prishtinës	Ekonomiks BSc
Universiteti i Prishtinës	Ekonomiks MSc
Universiteti i Prishtinës	Kontabilitet BSc
Universiteti i Prishtinës	Marketing BSc
Universiteti i Prishtinës	Marketing MSc
Universiteti i Prishtinës	Banka dhe Financa BSc
Universiteti i Prishtinës	Banka dhe Financa MSc
Universiteti i Prishtinës	Menaxhment BSc
Universiteti i Prishtinës	Menaxhment MSc
Universiteti i Prishtinës	Paraja, Banka, Financa dhe Sigurime MSc
Universiteti i Prishtinës	Agrikulturë urbane MSc
Universiteti i Gjilanit	Menaxhment dhe Ndërmarrësi BSc
Universiteti i Gjilanit	Juridik i përgjithshëm BSc
Universiteti i Prizrenit	Administrim biznesi MSc

5.2.2. AKREDITIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PRIVAT

Në IAL-ët private gjatë vitit 2020 kishin akreditim gjithsej 128 programe të studimit, prej tyre një program i nivelit të V-të sipas KKK, 87 të nivelit Bachelor dhe 40 programe të nivelit Master. Këtij numri iu shtuan edhe 14 programe të cilat u akredituan gjatë vitit 2020.

Programet e IAL-ve private që iu nënshtruan vlerësimit dhe u akredituan në vitin 2020:

Institucioni	Programi
Kolegji AAB	Menaxhment MA
Kolegji AAB	Infermieri BSc
Kolegji AAB	Juridik LLB Prishtine
Kolegji AAB	Juridik LLB Ferizaj
Kolegji AAB	Juridik LLB Gjakove
Kolegji AAB	Juridik penal LLM
Kolegji UBT	Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi MSc
Kolegji UBT	Infermieri BSc
Kolegji UBT	Politika publike dhe Menaxhimi MA
Kolegji UBT	Juridik LLB
Kolegji UBT	E Drejta Nderkombetare dhe Europiane e Biznesit LLM
Kolegji Rezonanca	Stomatologji (program i integruar)
Kolegji Heimerer	Shkencat Shëndetësore për Profile Diagnostike - Teknik Laboratori
Kolegji ESLG	Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës (MA)

6. MONITORIMI

Në lidhje me procedurat e monitorimit, Agjencia e Kosovës për Akreditim, në përputhje me nenin 7, pika 2 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04 / L-037¹⁷, dhe nenin 29 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e IAL-ve në Kosovë Nr. 15/2018¹⁸ është e obliguar të kryejë monitorim dhe inspektim të institucioneve të akredituara të arsimit të lartë. AKA kërkon që të gjitha IAL-të e akredituara detyrimisht të paraqesin, në fund të çdo viti akademik, një plan të implementimit të rekomandimeve të dhëna nga ekipi i ekspertëve në Raportin e tyre të vlerësimit.

AKA aktualisht bën monitorimin e institucioneve të arsimit të lartë përmes analizës dhe verifikimit të kualifikimeve të stafit akademik për të siguruar që IAL-të përmbushin kërkesat minimale. AKA ka kontrolluar rregullisht nëse IAL-të ruajnë kriteret minimale në lidhje me stafin akademik. Të gjitha dosjet e personelit të institucioneve të arsimit të lartë i dorëzohen AKA-së dhe pas kontrollit dhe verifikimit të kujdesshëm për të siguruar që ato plotësojnë kriteret formale, përpilohen listat finale, të cilat i dërgohen për shqyrtim Këshillit Shtetëror të Cilësisë.

Nëse KSHC-ja konsideron se kriteret minimale nuk janë përmbushur, bën tërheqjen e akreditimit të programit në fjalë. Përgjegjësitë e AKA-së gjithashtu përfshijnë një procedurë përcjellëse dhe monitorimin e përgjigjeve të IAL-ve ndaj vendimeve të KSHC-së.

¹⁷ <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/2-ligji-per-arsimin-e-larte.pdf>

¹⁸ <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/10/ilovepdf-merged.pdf>

7. APROVIMI I STANDARDEVE TË REJA TË PHD 2020

Në dhjetor të vitit 2019 AKA kishte organizuar një Punëtori të sponsorizuar nga Projekti HERAS për të diskutuar dhe zhvilluar standardet për programet PhD, në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësuesit e institucioneve të arsimit të lartë, anëtarë të KSHC-së dhe stafi i AKA-së. Nga kjo punëtori ishte zhvilluar një draft-dokument për nevoja të AKA dhe KSHC, që paraqiste pikënisje shumë të mirë për diskutime të mëtejshme dhe zhvillim rreth standardeve për vlerësimin e programeve të doktoratës. Puna e mëtejme e zhvilluar mbi bazë të këtij draft-dokumenti rezultoi me përfshirjen e disa standardeve të cilësisë që më parë ishin opsionale për IAL, dhe me promovimin e tyre në standarde substanciale.

Ky rishikim i standardeve të cilësisë për programet e doktoratës rezultoi me ngritjen e numrit të standardeve për vlerësimin e programeve të doktoratës gjë që paraqet një fuqizim të konsiderueshëm të standardeve.

Në vazhdim, gjatë revidimit të dokumentit, AKA ka shtuar standardet e mëposhtme, të cilat nuk kanë qenë në draft dokumentin, si standarde thelbësore:

2.4. Aplikantët duhet të demonstrojnë njohuri të mjaftueshme të gjuhës angleze.

7.2. Teza e doktoratës duhet të reflektojë mendimin kritik dhe të paraqes një vlerë të shtuar në bazën e njohurive për temën.

Standardet e mëposhtme kanë qenë opsionale (plotësuese) në draft dokumentin, kurse në dokumentin e reviduar AKA i ka ngritur në substanciale- thelbësore:

2.3. Në procesin e seleksionimit të kandidatëve për doktoratë duhet të vlerësohet potenciali i tyre për hulumtim.

5.6. Përgjegjësitë e institucionit, mentorit dhe studentit të doktoratës duhet të jenë të qarta në dokumentin e politikës.

6.4. Institucioni duhet ta ketë protokollin e dokumentuar qartë për procesin e vlerësimit, duke përfshirë edhe përbërjen e komisionit të vlerësimit.

6.7. Institucionet duhet të kenë politikat dhe procedurat e qarta sa i përket shkeljeve, siç janë: praktika jo etike, plagjiatura, fabrikimi i të dhënave, etj.

6.9. Mentori nuk duhet të jetë anëtar i komisionit të vlerësimit.

7.2. Teza duhet të reflektojë mendimin origjinal dhe të paraqes vlerë të shtuar në bazën e njohurive për temën.

Dokumenti final, i aprovuar në mbledhjen e KSHC-së të datës 25 qershor 2020, përbëhet nga gjithsej 52 standarde: 36 standarde substanciale (thelbësore) dhe 16 opsionale-zgjedhore. Dokumenti po ashtu përfshin kushtet që duhet plotësuar për të qenë standardi në pajtueshmëri të plotë, në mënyrë substanciale, pjesërisht në pajtueshmëri apo jo në pajtueshmëri me standardet.

Standardet e rishikuara për akreditimin e programeve të doktoratës së bashku me Udhëzuesin për plotësimin e RVV janë bërë publike dhe kanë filluar implementimin gjatë procesit të akreditimit të programeve PhD në vitin 2020.

8. KOMISIONI I ANKESAVE

E drejta ankimore e IAL ndaj vendimeve të KSHC-së është e rregulluar me nenin 22 të UA 15/2018,¹⁹ sipas të cilit IAL-ët mund të ankohen kundër vendimit të KSHC-së brenda një afati kohor prej 30 ditësh nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KSHC-së për akreditim, procedurë kjo që është në përputhje me Ligjin mbi procedurën Administrative.²⁰ Funkcionimi i Komisionit të ankesave rregullohet me Rregulloren Nr.2/2019²¹ për funksionimin e Komisionit të Ankesave të AKA-së. Ky komision pranon ankesat e IAL-ve dhe brenda një afati 30 ditësh duhet ti shqyrtojë ato dhe të kthejë përgjigje te IAL. Një Komision i pavarur i ankesave u formua në shtator të vitit 2020, dhe përbëhet prej 5 anëtarëve të jashtëm prej të cilëve 3 janë të përhershëm, kurse 2 tjerë janë anëtarë rezervë. Njëri prej anëtarëve të përhershëm është jurist me profesion, me përvojë mbi 10 vjeçare. Mandati i anëtarëve të komisionit është 2 vjet.

Në vitin 2020, komisioni ka pranuar 15 ankesa ndaj vendimeve të KSHC, një ka qenë nga një universitet publik, kurse 14 tjera nga kolegjet private. Pas shqyrtimit të tyre, komisioni ka aprovuar si të bazuar një kërkesë, një tjetër pjesërisht të bazuar, kurse 13 ankesa janë refuzuar si të pabaza, që kanë konfirmuar vendimet e KSHC-së.

¹⁹ <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/10/ilovepdf-merged.pdf>

²⁰ <https://mpb.rks-gov.net/ap/desk/inc/media/FC95CB25-50B5-4385-A800-CB31810A35CC.pdf>

²¹ http://akreditimi-ks.org/docs/LawRegulation/Rregullorja_e_komisionit_te_ankesave.pdf5 Administrative Instruction on Amendment a

9. SIGURIMI I BRENDSHËM I CILËSISË SË PUNËS SË AKA

AKA me përkrahjen e ofruar nga projekti “Përkrahja e AKA-së në përm-bushjen disa rekomandimeve të ENQA”, nga Ambasada Amerikane dhe i zbatuar nga WUS Kosova, ka zhvilluar Manualin për vlerësimin e brendshëm të stafit i cili është mekanizëm që do të ndihmojë në menaxhimin dhe zhvillimin e personelit të punësuar në AKA.

Ky manual bazohet në Procesin e menaxhimit të performancës dhe shërben për qëllime administrative dhe zhvillimore. Qëllimi i këtij manuali është që të ofrojë udhëzime për zhvillimin e procesit të vlerësimit të performancës së stafit, proces ky që do të zbatohen nga AKA. Me ndihmën e këtij procesi AKA është e përkushtuar që të përkrah secilin anëtar të stafit të vet që të zhvillojë potencialin e tij dhe të arrijë qëllimet personale, të cilat nga ana tjetër do të ndihmojnë AKA-në në arritjen e objektivave të saj.

10. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR, PARTNERITETI DHE PROJEKTET

AKA është pjesë e rrjeteve ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe merr pjesë në aktivitete me karakter ndërkombëtar:

- AKA është anëtare e Rrjetit të Agjencive për sigurimin e Cilësisë në Evropën Qendrore dhe Lindore-CEENQA²². Në vitin 2014, AKA ka qenë mikpritëse e takimit vjetor të CEENQA, që u mbajt në Prishtinë.
- Në vitin 2018 AKA ka prezantuar përvojën e saj në akreditim Agjencisë së Akreditimit të Maqedonisë Veriore.
- AKA ka një marrëveshje joformale me Agjencinë shqiptare të akreditimit për shkëmbimin e ekspertëve ndërkombëtar të vlerësimit
- AKA është anëtare e INQAAHE²³, Rrjeti Ndërkombëtar i Agjencive për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë
- Në vitin 2014 AKA u pranua në ENQA, prej së cilës u përjashtua në vitin 2019, pas një procesi të vlerësimit të parakohshëm pas përjashtimit nga EQAR
- Në vitin 2015 AKA u pranua në EQAR (Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë), prej së cilës u përjashtua në vitin 2017 si pasojë e ndërrhyrjeve politike që cenuan pavarësinë e saj.

²² Central and Eastern European Network of Quality Assurance Agencies in Higher Education. <https://www.ceenqa.org/>

²³ The International Network for Quality Assurance Agencies in Higher Education (INQAAHE) <https://www.inqaahe.org/>

Situata emergjente e krijuar nga pandemia-Covid-19 në vitin 2020 ka shkaktuar ndryshimin e agjendave dhe mënyrën e organizimit të shumë aktiviteteve në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Evropë dhe më gjerë. Përkundër kësaj, AKA ka vazhduar mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme me CEENQA, me INQAAHE si dhe me partnerë tjerë ndërkombëtarë.

CEENQA (në publikimin e saj në Dhjetor të vitit 2020, Vol. 10, No.2²⁴) ka lavdëruar punën e AKA lidhur me organizimin e procesit të akreditimit në kushte të pandemisë. Në këtë artikull potencohet se AKA ka qenë një prej agjencive të para shtetërore të SC që ka filluar vlerësimin e institucioneve të AL në distancë.

Gjithashtu potencohet se AKA para fillimit të procesit të vlerësimit të IAL-ve, ka mbajtur trajnime online me ekspertët e jashtëm të angazhuar në procesin e vlerësimit. Qëllimi i këtyre trajnimeve ka qenë njoftimi i ekspertëve me standardet e AKA-së, veçanërisht ekspertët të cilët kanë vlerësuar për herë të parë në AKA. Gjithashtu, gjatë trajnimeve janë dhënë informatat lidhur me procedurat e vlerësimit në distancë, sepse ishte diçka që po realizohej për herë të parë.

Në Tetor të vitit 2020, konkretisht më 12 dhe 13 tetor, AKA ishte pjesë e një vlerësimi/ ushtrimi për të matur plotësimin e Standardeve dhe udhëzueseve Evropiane për Sigurimin e Cilësisë, e organizuar nga Qendra Regjionale për bashkëpunim (RCC). Qëllimi i këtij ushtrimi ishte që të përkrahën agjencitë për SC në shtetet e Ballkanit perëndimor në përgatitjen për anëtarësimin e tyre në ENQA dhe regjistrimin në EQAR. Nëpërmjet këtij ushtrimi agjencitë për sigurimin e cilësisë do të identifikonin mangësitë dhe dobësitë e tyre, të cilat do të mund të paraqisnin pengesë për anëtarësimin e tyre në ENQA dhe EQAR. Ky vlerësim u organizua në distancë nëpërmjet platformave online me pjesëmarrje të stafit të AKA, anëtarëve të KSHC-së dhe palëve të interesit.

²⁴ CEENQA -Newsletter-December 2020
https://www.ceenqa.org/wp-content/uploads/CEENQA-Newsletter_December_2020_version_12-07.pdf

AKA-ja në veprimtarinë e vet gjithashtu i ka kushtuar rëndësi të posaçme bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare dhe pjesëmarrjes në projekte të ndryshme të cilat përkrahin punën e AKA.

Në vitin 2020 Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) dhe Projekti për Arsim të Lartë, Hulumtim dhe Shkencat e Aplikuara Plus (HERAS+), kanë nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit, nëpërmes të cilit AKA do të përfitojë përkrahje institucionale dhe teknike për forcimin e kapaciteteve për zhvillimin dhe rregullimin e arsimit të lartë, si dhe plotësimin e kriterëve për kthimin e Kosovës në Asociacionin Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA).

Nëpërmjet projektit QAIN (Cilësi, Llogaridhënie, Integritet dhe Transparencë Në Arsimin e Lartë), i cili financohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim (Austrian Development Agency - ADA), AKA do të përkrahet në ngritjen e kapaciteteve për t'i monitoruar ofruesit e arsimit të lartë, zhvillimin e Rregullores për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, e cila tashmë është në fazat e finalizimit, si dhe implementimin e rekomandimeve të ENQA-s si pjesë e përpjekjeve për tu rikthyer në këtë rrjetë të agjencive të SC, si dhe në EQAR.

Partneri zbatues i projektit, Kosovo United State Alumni (KUSA) i angazhuar nga Ambasada e SHBA-së në Prishtinë, ka nënshkruar më 21.09.2020 kontratat me Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) dhe partnerin zbatues WUS Kosova, për financimin e dy projekteve, në vlerë prej 65 mijë dollarë, të cilat kanë për qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale dhe teknike të Agjencisë së Akreditimit dhe plotësimin e kriterëve kryesore për kthimin e anëtarësimit të Kosovës në Asociacionin Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA).

Së fundmi, AKA ka aplikuar së bashku me Agjencinë e Akreditimit të Austrisë, dhe është shpallur fituese, për një projekt binjakëzimi, i cili do të financohet nga Heras+. Projekti në vlerë €40.000 ka për qëllim binjakëzimin e dy agjencive homologe dhe shkëmbimin e përvoja në fushën e ngritjes së cilësisë në arsimin e lartë.

11. MENAXHIMI I TË DHËNAVE

Agjencia posedon arkivin elektronik dhe backup-in për të gjitha të dhënat dhe materialin sensitiv.

12. MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Publiku i gjerë, e posaçërisht studentët, mund të informohen për punën e AKA-së dhe KSHC-ës nëpërmjet web faqes së saj <https://akreditimi.rks-gov.net/>

Në faqen e re të AKA-së janë të publikuara të gjitha informatat mbi vendimet e KSHC-së për akreditimin institucional dhe të programeve të IAL për secilin vit të veprimtarisë së saj. AKA është një nga institucionet e rralla në Republikën e Kosovës që të gjitha të dhënat i ka të publikuara në adresën e saj në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht.

Gjithashtu ka të publikuara të gjitha aktet ligjore në të cilat bazohet veprimtaria e AKA-së, procedurat e akreditimit, standardet, manualët, projektet dhe partneritetet me institucione tjera.

Gjatë këtij viti nuk pat asnjë lajm negativ për AKA në mediat kosovare dhe as nga shoqëria civile.

13. REKOMANDIMET E ENQA-SË DHE VEPRIMET E DOMOSDOSHME PËR PËRMBUSHJEN E TYRE

AKA në vitin 2014, pas një vlerësimi pozitiv nga një panel i ekspertëve të ENQA-s kishte konfirmuar plotësimin në nivel të kënaqshëm të Standardeve dhe Udhëzuesve Evropian për Sigurimin e cilësisë (ESG) dhe ishte pranuar anëtare e plotë në ENQA.

Në vitin 2015, AKA aplikoi për anëtarësim në EQAR dhe u pranua. Ky anëtarësim i mundësoi AKA-së përfshirjen në regjistrin Evropian të Agjencive për Sigurimin e Cilësisë, e barabartë me të gjitha agjencitë e ngjashme në vendet e Evropës.

Shkarkimi i anëtarëve të KSHC dhe U.D Drejtorit të AKA në shtator të vitit 2017 rezultoi me përjashtimin e AKA nga EQAR në shkurt të vitit 2018.

Pas kësaj, pasoi njoftimi nga ENQA se shkarkimi i anëtarëve të KSHC paraqet shqetësim për pavarësinë e AKA, e me këtë edhe për përmbushjen e standardeve evropiane ESG.

Më 19 prill 2018 Asambleja Gjenerale e ENQA-s vendosi që AKA të jetë “Anëtare nën vlerësim”. Vizita nga Ekipi i vlerësuesve të jashtëm të ENQA-s në AKA u realizua në mars të vitit 2019. Vendimi i ENQA-s në shtator të vitit 2019 ishte se AKA nuk përmbush standardet për ri-akreditimi, prandaj ajo humb statusin e anëtarit të saj.

ADRESIMI I REKOMANDIMEVE TË BORDIT TË ENQA-S

Citat: “3.1. ENQA Aktivitetet, politika dhe procesi për sigurimin e cilësisë

Bordi ndan shqetësimin e panelit për mungesën e një konsensusit të gjerë në arsimin e lartë për rolin dhe aktivitetet e agjencisë që do të ishin bazë për një planifikim strategjik të shëndoshë të AKA-s.”

AKA ka emëruar një grup ekspertësh për hartimin e Planit Strategjik. Drafti i parë i Planit Strategjik tashmë është finalizuar dhe do të jetë në diskutim publik. Ky plan duhet të definojë objektivat strategjike për një periudhë të caktuar dhe indikatorët e qartë për matjen e përmbushjes së tyre. Në Planin Strategjik të AKA-së do të japin kontribut edhe një ekspert amerikan i angazhuar nga Ambasada Amerikane dhe një ekspert austriak i angazhuar nga Projekti Heras+.

Citat “3.4. ENQA Analiza tematike

Raporti i vlerësimit thotë: “sondazhi mbi opinionet e palëve të interesit (SR2017) paraqet informacion të dobishëm, por mungon një lidhje e ngushtë me gjetjet e përgjithshme të aktiviteteve të sigurimit të jashtëm të kryera nga AKA. Zhvillimet, tendencat dhe fushat e praktikës së mirë

ose vështirësitë e vazhdueshme duhet të bëhen të qarta, për t'i sjellë këto raporte më afër me udhëzimin për standardin aktual të ESG “. Bordi i kërkon agjencisë të ndjekë më nga afër kërkesën e standardit.”

AKA, në kuadër të projektit të financuar nga Ambasade Amerikane në Kosovë dhe me partnerin zbatues WUS Kosova, kanë zhvilluar metodologjinë e hartimit të analizave tematike dhe kanë realizuar dy analiza tematike. E para ka të bëjë me nevojat e tregut të punës për profesione të caktuara në Kosovë dhe analiza e dytë tematike ndërlidhet me procesin e akreditimit institucional.

Tani AKA posedon metodologjinë e hartimit të analizave tematike dhe në të ardhmen do ti zhvillojë ato me resurset e saja vetanake.

Citat “3. 5. ENQA: Bordi është i brengosur me mungesën e resurseve humane dhe atyre financiare të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve që priten nga AKA”

Momentalisht AKA funksionon me 7 anëtarë të personelit dhe drejtorin e AKA.

Çështja e mungesës së stafit është adresuar te institucionet relevante, dhe sipas Ligjit për ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2020²⁵, AKA ka buxhet për plotësimin e 32 pozitave. Megjithatë, procedurat e komplikuar administrative nga Departamenti i Shërbimit Civil, në kuadër të MPB-së, janë pengesë për përzgjedhjen e duhur të stafit të kualifikuar për nevojat e AKA. Gjithashtu pagat e ulëta në krahasim me volumin e punës së stafit janë dekurajuese për kandidatët potencialë që aplikojnë për të qenë staf në AKA.

Infrastruktura (ndërtesa) në të cilën momentalisht funksionon AKA është shumë e kufizuar për ta mundësuar zhvillimin e kapaciteteve të plota humane të AKA. Kjo çështje është adresuar në Qeveri dhe MASHT dhe pritet

²⁵ LIGJI NR. 07/L-001 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIK S S KOSOV S P R VITIN 2020
<https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=27690>

që në vitin 2022 AKA të kalojë në një objekt të ri në afërsi të Pallatit të Drejtësisë në të cilën do të ketë në dispozicion 1200 m/katror sipërfaqe.

Një grup punues i krijuar nga MASHTI ka hartuar draftin e Ligjit për AKA dhe e ka dorëzuar në MASHTI i cili duhet ta dërgojë për miratim në Kuvend. Ky ligj do të fuqizonte pavarësinë e AKA si në aspektin e organizimit dhe funksionimit ashtu edhe në atë financiar.

Citat “3.6. ENQA: Sigurimi i brendshëm i cilësisë dhe sjellja profesionale

Bordi konsideron se është më i nevojshëm implementimi i mekanizmave zyrtarë/formal sesa i atyre informal për të krijuar rutina të qëndrueshme të sigurimit të brendshëm të cilësisë, siç rekomandohet nga paneli.”

AKA e përkrahur nga projekti i Ambasadës Amerikane, i implementuar nga WUS Kosova, ka hartuar Manualin për vlerësimin e brendshëm të stafit. Ky manual bazohet në Procesin e menaxhimit të performancës dhe shërben për qëllime administrative dhe zhvillimore. Qëllimi i këtij manuali është që të ofrojë udhëzime për zhvillimin e procesit të vlerësimit të performancës së stafit, që do të zbatohen nga AKA.

Citat “ 2.3 ENQA: Implementimi i proceseve

Në raportin e vlerësimit shkruan: “Gjatë një viti e gjysmë nuk është bërë asnjë rishikim i aplikacioneve të plota”. Për më tepër, paneli shpjegon: “në 2018 është lejuar vazhdimi i akreditimit aktual/ekzistues për një vit të plotë. Nuk ka pasur monitorim të përmbushjes së rekomandimeve nga vlerësimi i mëparshëm. Monitorimi ka qenë i limituar vetëm në kërkesat formale, si: kontroll në vend të ngritjes së cilësisë. Për këtë çështje rekomandimi i vitit 2014 nuk është ndjekur.

Bordi vë në plan të dytë vërejtjet kritike të panelit dhe nxit agjencinë të ofrojë proceset e jashtme të sigurimit të cilësisë që janë në përputhje me

standardin, d.m.th. të besueshëm, të dobishëm, të përcaktuar paraprakisht, të zbatuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të publikuara.”

Si pasojë e shkarkimit të Bordit të AKA (KSHC) dhe të u.d. drejtorit nga ish-ministri i Arsimit në vitin 2017, gjatë vitit 2018 AKA nuk ka kryer asnjë proces të vlerësimit të institucioneve dhe programeve të tyre. Kjo ngecje ka shkaktuar çrregullimin e vlerësimit periodik të IAL-ve dhe programeve të tyre.

Pas emërimit të anëtarëve të rinj të KSHC dhe u.d. Drejtorit në vitin 2019, AKA ka vazhduar me procesin e akreditimit të IAL-ve dhe programeve të tyre.

Në vitin 2020, edhe pse në kushte të emergjencës së shkaktuar nga pandemia Covid-19, AKA ka organizuar procesin e akreditimit institucional dhe të programeve në distancë (online), duke ndjekur përvojat më të mira evropiane në këtë aspekt.

Për shkak të kapaciteteve të limituara njerëzore, AKA ende nuk mund të bëjë monitorimin e IAL-ve në terren. Angazhimi sa më i shpejtë i një numri të konsiderueshëm të stafit shtesë në AKA do të mundësojë monitorimin e mirëfilltë të IAL-ve të akredituara dhe përmbushjen e rekomandimeve nga vlerësimi paraprak.

Gjatë vitit 2021, AKA ka vlerësuar të gjitha programet që kanë aplikuar, dhe pritet që nga tetori 2021, asnjë program akademik në Kosovë nuk do të mbetet pa iu nënshtruar procesit të vlerësimit.

Citat “2.4 ENQA: Ekspertët e jashtëm

Bordi ndanë shqetësimin e panelit vlerësues se ekspertët e jashtëm duhet të posedojnë shkathtësitë e duhura dhe kompetencat për të realizuar detyrat e tyre, si dhe të jenë mjaftueshëm të përkrahur me trajnime dhe informata.

Siç thuhet në Raport: “do të ishte e dobishme që të punohet më shumë në përgatitjen e ekspertëve lidhur me kërkesat e Manualit për akreditim të vitit 2018 dhe të ketë takim në mes të ekspertëve për të bërë të mundur një vlerësim të qëndrueshëm për shumë standarde në MA 2018.

Për më tepër, Bordi kërkon që AKA të konsideron seriozisht rekomandimin e panelit dhe të garanton pjesëmarrjen e studentëve në vlerësimin institucional dhe të programeve. “

Për të adresuar këtë rekomandim të ENQA-s, AKA në bashkëpunim me projektin Heras+ kanë hartuar dhe kanë përfunduar procedurat e miratimit të manualit për ekspertë të jashtëm. Ky manual u dorëzohet ekspertëve të jashtëm të vlerësimit para se të fillojnë procesin e vlerësimit të jashtëm²⁶.

Përveç kësaj, për të plotësuar këtë kriter, AKA bën trajnimin e të gjithë ekspertëve të jashtëm që marrin pjesë në procesin e akreditimit.

Lidhur me rekomandimin për angazhimin e studentëve në vlerësimin institucional dhe të programeve, AKA ka filluar ta trajtojë seriozisht këtë rekomandim dhe në procesin e akreditimit në vitin 2020 ka angazhuar 3 studentë në Ekipet vlerësuese.

Për të siguruar një përzgjedhje sa më të mirë të ekspertëve të jashtëm, KSHC ka kërkuar që, përveç listës me emra të ekspertëve të cilët do të angazhohen në Ekipet e vlerësimit, të sillën edhe CV e tyre, prej të cilave mund të shihet përgatitja e tyre profesionale. Një vlerësim i tillë do të mundësojë angazhimin e secilit ekspert në programet e fushave që përkohjnë me kualifikimin e tij.

Praktikat e mëhershme të AKA kanë dëshmuar se takimet e anëtarëve të Ekipit të ekspertëve ndërmjet veti dhe me stafin e AKA një ditë para vizitës në institucionin nën vlerësim janë të domosdoshme dhe të dobishme për njohjen e ekspertëve, si dhe për të diskutuar lidhur me IAL-ën ose programin e studimit që do të vlerësohet.

²⁶ <https://akreditimi.rks-gov.net/about-us/dispozitat/dokumente/>

Citat “2.6. ENQA Raportimi

Raportet e plota duhet të publikohen rregullisht dhe të mbështeten më mirë me fakte/prova”

AKA posedon ueb faqen e vet e cila është e para në Kosovë që plotëson tri gjuhësinë, shqip, serbisht dhe anglisht.

Në ueb faqen e saj AKA ka publikuar të gjitha Raportet e vlerësimit të IAL -ve publike dhe private dhe programeve të tyre të studimit prej vitit 2010.²⁷

²⁷ <https://akreditimi.rks-gov.net/vendime/>

